

Relacion

Mbi verifikimin e punimeve të mbetura në objektin:

"Plotësimi i punimeve në segmentin rrugor Qukës - Qafë Ploçë - Loti 0"

Bazuar në Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 300, datë 01.10.2024, Grupi i Punës bëri verifikimin e punimeve të mbetura në objektin: "Plotësimi i punimeve në segmentin rrugor Qukës - Qafë Ploçë - Loti 0," nga km 0+000 ÷ 2+900".

Punimet në objektin "Ndërtim rruga Qukës – Qafë Ploçë", Loti 1 kanë filluar në Qershor të vitit 2009 dhe kanë përfunduar në Dhjetor të vitit 2014.

Projektin e këtij segmenti rrugor është paraqitur pranë ARRSH në vitin 2008 nga Komuna Qukës dhe është hartuar nga firma projektuese "SPHAERA".

Gjatë zbatimit të punimeve ndodhi një rreshqitje masive ku përveç fshatit që ishte në krahun e majtë të rrugës u dëmtua në një shkallë të konsiderueshme dhe trupi i rrugës, muret pritës prej betoni, veprat e artit si tombino etj.

Si rezultat i këtij fenomeni të rrëshqitjes u bë spostimi i aksit në një gjatësi rreth 800ml, i cili kishte një kosto shtesë prej 20% të vlerës së kontratës.

Theksojmë se dhe me fondet shtesë, objekti nuk përfundoi 100% dhe nuk u vendos në shfrytëzim, pasi mbetën pa u realizuar shtresat rrugore, sinjalistika horizontale, vertikale, siguria rrugore, disa elemente të urës, kunetat e betonit, kanalet, fibra optike.

Aktualisht trupi i rrugës nuk ka çedime apo dëmtime.

Kurora e rrugës sipas projektit është me gjerësi totale 12.5m e cila përfshin:

- korsi trafiku 2 x 3.75m të gjëra;
- bankinë asfaltuara 2x1.5m;
- bankinë të pa asfaltuar 2x1.0m në secilën anë.

Kanalet janë pjesë e trupit të rrugës.

Grupi i Punës doli në përfundimin se në këtë Lot i cili fillon në km 0+000 ÷ 2+900 kanë mbetur pa realizuar këto zëra punimesh:

- Shtresat rrugore:
 - Shtresa e veshjes (tapeti) 5 cm;
 - Shtresa lidhëse (binderi) 6 cm;
 - Shtresa e konglomeratit 10 cm;
 - Shtresa bazë (material i grimtuar dhe i fraksionuar 0 - 31,5mm) trashësi 15cm e shtrirë, niveluar dhe i ngjeshur me makineri (2 x 15cm) = 30 cm;
 - Gërmim i trupit të rrugës deri në 30cm, bazuar në inspektimin vizual në terren dhe disa kontrolle topografike në pika të ndryshme të trupit të ndërtuar të rrugës.
- Mbrojtja e pjerrësive dhe Drenazhimi i Ujit. Duke pasur parasysh se në Projektin origjinal nuk parashikohet asgjë për masat e mbrojtjes së pjerrësive, mbrojtja e

pjerrësive do të trajtohet si një çështje më vehte, ku sipas inspektimit në terren, duket se rreth 50% e sipërfaqes kërkon mbrojtje me elementet e kombinuar:

- Zonat e mbushjes;
 - Zbutja e pjerrësive me shtresë vegjetacioni dhe mbjellje bari;
 - Mbjellje bari në pjerrësitë e gërmuara ose mbjellje me vegjetacion të lartë akacie;
 - Furnizimi dhe mbjellja e rrëshqitjeve të barit të rrënjosur;
- Punime në urë;
 - Kunetë betoni;
 - Siguria Rrugore: Instalimi i barrierave mbrojtëse në anë të rrugë si dhe në anë të veprave të artit (ura, mure mbajtës, tombino etj.);
 - Plotësimi me Sinjalistikë vertikale dhe horizontale gjatë gjithë gjatësisë së segmentit rrugor;
 - Instalimi i kanaleve për fibra optike: Sipas “Rregullave Teknike dhe Projektimit të Detajuar” të miratuara nga vendimi i Këshillit Teknik të ARRSH-së Nr. 36/No. 6427 Prot., datë 22/09/2014.